



Permbledhje joteknike e aktiviteve per Leje Mjedisore



“Industritë energjetike, ID 1.7 Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave”

“Industritë energjetike, ID 1.10, Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.”

Subjekti: “Xhaferri 2013” Sh.p.k

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Erina MADANIJEK



Tirane, 2025



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisitetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti “Xhaferri 2013” Sh.p.k me administrator Z.Xhimi Xhaferri eshte regjistruar prane QKR me NIPT L36322401Q. Subjekti kërkon te ushtroje aktivitetin “Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave” dhe “Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.”, ne vendndodhjen Diber, Bulqize, Fushe-Bulqize, Zona kadastrale nr.1660 dhe Nr.Pasurie 618/8.



Nr.	X	Y
1.	4440280.93	4598163.34
Sip. Totale (m ²)		2700 m ²



➤ Procesi teknologjik per karburantin dhe GNL

Përshkrimi i Procesit Teknologjik të Rezervuarit Mbitokësor për GLN – 5000 litra

Rezervuari mbitokësor për GLN (Gaz i Lëngshëm i Naftës) me kapacitet 5000 litra është projektuar për të ruajtur dhe shpërndarë GLN në mënyrë të sigurt dhe efikase, në përputhje me standardet ndërkombëtare për ruajtjen e gazrave të lëngshëm nën presion.

1. Struktura dhe Vendosja

Rezervuari është me konstrukcion horizontal, prej çeliku të veçantë për presion të lartë dhe i fiksuar mbi platforma betoni të përforcuara. Ai është i pajisur me izolim termik për të ruajtur qëndrueshmërinë e temperaturës dhe për të mbrojtur nga ndikimi i rrezeve diellore. Struktura e tij garanton siguri maksimale ndaj presioneve të brendshme dhe kushteve atmosferike.

2. Komponentët dhe Funkcionet Teknologjike

a. Siguria dhe Monitorimi

Valvola sigurie DN $\frac{1}{2}$ " P=23 bar dhe valvola sigurie mbi rezervuar DN2", e taruar në 17.65 bar: Këto valvola aktivizohen automatikisht për të çliruar gazin në rast të tejkalimit të presionit të lejuar, duke mbrojtur sistemin nga mbingarkesat.

Manometra Ø50 dhe Ø100 me diapazon 0-25 bar: Vendosur në pika kyçe të sistemit, lejojnë monitorim të saktë të presionit të brendshëm në rezervuar dhe në linjat e shpërndarjes.

Tregues niveli rrotativ (montim vertikal): Jep informacion në kohë reale për nivelin e GLN në rezervuar.

b. Sistemi i Qarkullimit dhe Shpërndarjes

Valvolat sferike DN2" PN40 (7 cope): Përdoren për izolimin dhe drejtimin e rrjedhës së gazit në segmente të ndryshme të sistemit.

Valvol moskthimi DN $\frac{1}{4}$ " PN40 dhe valvol fluksi PN40: Parandalojnë kthimin e gazit në drejtim të kundërt dhe kontrollojnë rrjedhjen sipas drejtimit të paracaktuar.

Valvol bajpasi DN $\frac{1}{4}$ " PN40, diapazon 3.5–10.5 bar: Lejon rrjedhjen alternative në rast të bllokimit të linjës kryesore ose për rregullimin e presionit.

Filtri para pompës DN2" PN40: Mbron pompën nga papastërtitë që mund të jenë në rrjedhën e gazit, duke garantuar jetëgjatësi dhe funksionim efikas. Tub fleksibël DN2" dhe DN $\frac{1}{4}$ " PN40: Lejojnë lidhje të sigurt dhe fleksibël për shkarkimin e gazit nga rezervuari drejt pajisjeve të konsumit ose transportit.

c. Pompa dhe Mekanizmi i Shpërndarjes

Elektropompë centrifugale për GLN: Me parametra teknikë prurje 60 litra/min, lartësi (head) H=120 m dhe fuqi 4 kW, kjo pompë mundëson shpërndarjen e GLN me presion të lartë dhe në distanca të konsiderueshme. Është projektuar posaçërisht për gazra të lëngshëm me siguri të lartë dhe efikasitet optimal.

3. Sistemet Ndihmëse të Sigurisë



Sistem automatik për ndalim emergjent (emergency stop): Aktivizohet në rast situatash të rrezikshme për të ndërprerë menjëherë rrjedhën e gazit.

Sistem tokëzimi dhe mbrojtje nga ngarkesa statike: Parandalon krijimin e shkarkesave elektrike që mund të çojnë në shpërthim.

Sistem ventilimi i kontrolluar: Shmang akumulimin e avujve të gazit në zonat e ndjeshme përmes shkarkimit të sigurt të tyre në atmosferë.

Zona e sigurisë: Rezervuari dhe komponentët ndodhen brenda një perimetri të rrethuar, të pajisur me kamera vëzhgimi, sinjalistikë paralajmëruese dhe detektorë gazi. Në rast detektimi të rrjedhjeve, aktivizohen automatikisht alarmet akustike dhe vizive.

Përshkrimi i Procesit Teknologjik të Rezervuarit Nëntokësor të Naftës – 15,000 litra

Rezervuari nëntokësor për naftë me kapacitet 15,000 litra është cilindrik me bosht horizontal dhe konstrukcion të dyfishtë për parandalimin e rrjedhjeve dhe siguri maksimale. Ai është prej çeliku karboni me veshje antikorrozive dhe izolim të jashtëm për mbrojtje nga ndryshimet termike. Ngarkimi bëhet përmes lidhjeve hermetike “bottom loading” për të minimizuar avullimin dhe ekspozimin ndaj ajrit. Shpërndarja realizohet me pompa automatike me sisteme matëse precize dhe valvola ndalimi emergjent, të lidhura me sistemin qendror të monitorimit. Sistemet e ventilimit ruajnë presionin në nivele të sigurta, ndërsa kullimi i ujërave bëhet përmes separatorit naftë-ujë për mbrojtje të mjedisit. Ky sistem siguron ruajtje të sigurt dhe kontroll të vazhdueshëm të naftës në depozitë.

Përshkrimi i Rezervuarit Nëntokësor të Benzinës – 10,000 litra

Benzina, për shkak të natyrës së saj shumë të avullueshme dhe ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve të temperaturës dhe presionit, kërkon masa të rrepta sigurie. Depozita nëntokësore me kapacitet 10,000 litra është e ndërtuar me dy shtresa (double-wall tank) dhe sistem të integruar për zbulimin e rrjedhjeve ndërmjet shtresave. Rezervuari është i pajisur me sensorë avujsh të benzinës që lidhen me një sistem alarmi automatik dhe ndërprerës pompash në rast të përqendrimeve të rrezikshme. Sistemi i shpërndarjes përfshin pompë me çarkullim të mbyllur, matës me kalibrim automatik dhe valvola kontrolli për rrjedhje të qëndrueshme dhe të sigurt. Sistemi i ventilimit përmban linjën për rikuperim avujsh (VRU), e cila rikthen avujt në depozitë ose i kondenson për ripërdorim, duke parandaluar ndotjen e ajrit dhe ulur rrezikun e shpërthimit. Vendosja e këtij sistemi kërkon respektimin e distancave të sigurisë, sinjalistikës mbrojtëse dhe tokëzimit për parandalimin e ngarkesave elektrostike gjatë ngarkim-shkarkimit.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

- **Pozita Gjeografike**

Bashkia e Bulqizës ndodhet në rajonin verilindor të Shqipërisë dhe përfshin një sipërfaqe prej 694 km². Ajo shtrihet në koordinatat 41°37' gjërësi gjeografike veriore (Shupenzë), 41°21'30" (Trebisht), dhe 20°18'50" - 20°07'30" gjatësi gjeografike lindore (Martanesh). Kjo bashki kufizohet në veri me bashkinë Dibër, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug me bashkinë Librazhd, në jugperëndim me bashkinë Tiranë dhe në perëndim me bashkinë



Klos. Qendra e bashkisë është qyteti i Bulqizës, ndërsa tërësia e vijës kufitare arrin në 120 km. Bulqiza përbëhet nga 7 njësi administrative: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht.

- **Kushtet klimatike**

Rrethi i Dibrës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe atë mesdhetare paramalore meqënëse është pjesë e pellgjeve të lumenjve të Drinit. Dallohet për ndryshime të dukshme nga një sektor në një tjetër sidomos në drejtimin vertikal. Në formimin e kësaj klime kanë ndikuar faktorë si: lartësia dhe relievi i territorit, ndikimi i madh i klimës kontinentale nëpërmjet erave që vijnë nga grykat dhe qafat nga brendësia e ballkanit. si rezultat kjo klimë dallohet për klimë të ashpër, dimër të gjatë dhe reshje të mëdha të dëbores dhe verë të freskët por pa reshje. Temperatura mesatare shkon nga 6 ° C në malin e Korabit në 11 ° C në afërsi të luginës. Po ta krahasojmë me temperaturën mesatare të vendit tone ajo leviz nga 4°-8° C kuptohet që shkaku kryesor është lartësia mbi nivel të detit dhe pozicioni i saj lindor që kushtëzon një ndikim nga brendësia e ballkanit. Në periudhën prill-shtator temperatura mesatare është 16° C në afërsi të qytetit Për muajin korrik temperatura mesatare shkon nga 7 ° C në pjesë të larta dhe 16 ° C në afërsi të luginës. Muaji janar është muaji më i ftohtë i vitit ku mesatarja shkon nga 0° C në -3° C. Amplituda e temperaturës vjetore merr vlera jo të vogla që shkojnë rreth 17° C-18° C. Kurse amplituda ditore shkon deri 10-15° C, temperatura maksimale e zonës është rregjistruar në korrik të 1996 në qytet 39.5° C kurse ajo minimale është rregjistruar në 1959 kur ka arritur -20° C amplituda midis vlerave është relativisht jo e vogël që shkon 60° C. Për sa i përket sasise së rreshjeve zona futet në zonat nën masatën e vendit. Kjo vlerë shkon nga 900 mm (në Qarrishte) ky ndryshim lidhet me deporimin e erave të ftohta e të thata. Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në pjesën e ftohtë të vitit, 90 %, kurse në pjesën e ngrohtë bin rreth 10-15%. Muaji më i lagët është nëndori me 12% të rreshjeve afro 225 mm, kurse muaji më me pak reshje është korriku me 3.6% ose 46 mm. Maksimumi i rreshjeve në 24 ore ka qënë 127 mm. Për reshjet e dëbores mund të themi se fillojnë mesatarisht me 1 nëndor dhe data e mbarimit është 20 mars. Numri mesatar i ditëve me borë shkon 38 dite dhe krijon një shtresë mesatare prej 30-35 cm. Shtresa maksimale shkon 1.5 m në shpata të malit.

- **Relievi**

Relievi i Bashkisë së Bulqizës është kryesisht malor-kodrinor, me një lartësi që varion nga 300 deri në 2000 metra mbi nivelin e detit. Rajoni përshkohet nga një sërë malesh si: Mali i Lopës, Mali i Dhoksit, Kaptina, Homeshi, si dhe luginash të rëndësishme si Lugina e Bulqizës, Planit të Bardhë, Valit dhe Batrës. Zona paraqet një kombinim të formave të ndryshme relievi si relief strukturor-eroziv, karstik, akullnajor dhe eroziv-denudues. Qafa e Buallit përbën një pikë ndarëse midis dy luginave kryesore të zonës, dhe është gjithashtu një kalim natyror i erërave. Në lartësitë mbi 1500 m hasen forma të relievit akullnajor me liqene si ai i Zi, i Bardhë, Balgjajt dhe Kasnisë. Në zonën lindore, Golloborda paraqitet me relief të valëzuar, me fusha të mbyllura si ajo e Klenjës dhe Studnës

- **Gjeologjia**

Ndërtimi gjeologjik në këtë reth mundëson zhvillimin pasi kjo zonë është e pasur me



minerale, lende ndërtimi dhe mermerë. Ky ndërtim gjeologjik ka bërë që vendbanimet të vëndosen kryesisht në përbëriet gëlqerore dhe në kontaktet me shtresa të tjera për arsye të burimeve hidrike. Përbërja me argjila dhe gëlqerorë ka bërë që edhe oferta të jetë shumë e pasur për ta. Duhet theksuar se për sa i përket relievit në vendosjen e vendbanimeve dhe ndikimin e tij në zhvillimin social-ekonomik ai ka ndikuar në karakterin e një ekonomie të mbyllur dhe me drejtim në degën e blektorisë pasi oferta e tokave pjellore bujqësore është e kufizuar. Relievi ka qënë përcaktues edhe në arkitekturën e ndërtimeve dhe mënzres së jetesës në zona të izoluar. Ky reliev ka përcaktuar edhe vendosjen larg njëra-tjetrës të pronave të banuara duke lënë të lira tokat prodhuese. Ky rajon ka mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit. Peizazhe piktoreske ofron edhe parku kombëtar i Lurës si dhe pyjet e shumta, liqenet që janë shumë të bukura.

- **Toka/Flora/Fauna**

Bulqiza përmban një shumëllojshmëri tipesh toke, të cilat janë të shpërndara sipas lartësisë dhe kushteve gjeologjike. Tokat më të përhapura janë ato të kafejta, të cilat shtrihen në zonat kodrinore dhe janë të përshtatshme për bujqësi. Në lartësitë më të mëdha hasen tokat livadhore malore dhe ato të murrme pyjore, që janë të pasura me humus dhe të formuara nën ndikimin e klimës së ftohtë. Në fushat dhe luginat kryesore gjenden toka aluvionale, të formuara nga prurjet e lumenjve, veçanërisht në zonat e Shupenzës dhe Gjoricës. Në disa zona, si ajo e Bulqizës, hasen edhe toka torfike me kapacitet të lartë ujor, të përshtatshme për kultivim specifik.

Flora dhe fauna

Flora e Bulqizës është e pasur dhe e ndarë në kate sipas lartësisë. Në lartësitë 800–1100 m shtrihet kati i dushkut, me përhapje të dushkut, lisit dhe qarrit. Më lart, nga 1200–1800 m, ndodhet kati i ahut dhe halorëve, me dominim të pishës së zezë dhe bredhit të bardhë, të përhapura në zona si Bajgaj, Dhoks dhe Tërnovë. Mbi 1800 m haset kati i kullotave alpine, me bimësi barishtore që shfrytëzohen si kullota verore. Fauna është gjithashtu e larmishme: në malet e thella jetojnë ujçër, dhelpra, macja e egër, ndërsa në zonat më të ulëta hasen lepuj, iriqë, urithë e shumë lloje zvarranikësh. Zonat e pyllëzuara dhe fushat janë të pasura me shpendë si dallëndyshja, harabeli, trumçaku dhe shumë lloje të tjera shtegëtare dhe joshtegëtare.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni të kryer.



- **Shkarkimet në ujë**

Nga zhvillimi i aktivitetit në fjalë, nuk parashikohet ndotje e ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore. Aktiviteti në thelb nuk përfshin procese të cilat gjenerojnë shkarkime me përbërje ndotëse. Shkarkimet e vetme që do të ndodhin janë ato të ujërave higjeno-sanitare, të cilat do të drejtohen në rrjetin ekzistues të kanalizimeve të zonës. Rrjeti i kanalizimeve është i përfshirë në infrastrukturën komunale dhe mirëmbajtja e tij garanton që nuk do të ketë ndikime negative në sistemin hidro-gjeologjik të zonës.

- **Emetimet në ajër**

Aktiviteti i planifikuar nuk përfshin procese të cilat mund të çojnë në emetim të ndotësve të ajrit. Nuk do të ketë ndotje direkte nga aktiviteti, përveç emetimeve të kufizuara që lidhen me lëvizjen e mjeteve të transportit. Këto mjete janë në gjendje shumë të mirë teknike dhe përmbushin normat mjedisore të përcaktuara, gjë që siguron se emetimet janë minimale dhe nuk përbëjnë rrezik për cilësinë e ajrit të ambientit përreth.

- **Zhurmat dhe vibrimet**

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk parashikohet gjenerimi i vibrimeve. Aktiviteti nuk përfshin përdorimin e pajisjeve të rënda industriale ose të mjeteve të tonazhit të lartë që mund të shkaktonin zhurma ose lëkundje. Lëvizja e mjeteve të transportit është e kufizuar dhe bëhet në kushte që minimizojnë ndikimin akustik. Prandaj, ndikimi në ndotjen akustike të mjedisit konsiderohet i papërfillshëm.

- **Ndikimet në florë dhe faunë**

Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit dhe vendndodhjen e tij, nuk pritet të ketë ndikime negative në florën dhe faunën e zonës. Territori përreth subjektit nuk është habitat natyror i ndonjë specie të mbrojtur dhe nuk përfshihet në zona të mbrojtura mjedisore.

- **Ndikimet nga zjarri**

Janë marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut nga zjarri. Pika e karburantit është pajisur me mjete të posaçme për fikjen e zjarrit (fikse zjarri), në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë teknike.

- **Mbetjet e prodhuara**

Nga funksionimi i aktivitetit nuk pritet të gjenerohen mbetje prodhimi. Mbetjet e vetme që do të krijohen do të jenë ato urbane (mbeturina të zakonshme), të cilat do të grumbullohen në kosha të dedikuara. Më pas, këto mbetje do të transportohen dhe depozitohen në vendgrumbullimin zyrtar të përcaktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore, duke respektuar rregullat e menaxhimit të mbetjeve urbane.



4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

- **Masat për Shkarkimet në Ujë**

Për të siguruar mbrojtjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, janë marrë masa që të gjitha ujërat higjeno-sanitare të shkarkohen në rrjetin ekzistues të kanalizimeve të zonës. Territori i pikës së furnizimit do të jetë i shtruar dhe i izoluar për të parandaluar çdo rrjedhje të lëndëve të dëmshme në tokë. Ne raste aksidentale do te kryhet nderhyrje e menjehershme per te siguruar heqjen e menjehershme te ndiimeve.

- **Masat për Emetimet në Ajër**

Për të kufizuar emetimet në ajër, do të përdoren vetëm automjete në gjendje të mirë teknike, të cilat plotësojnë normat europiane për ndotjen e ajrit. Aktiviteti vetë nuk prodhon emetime të drejtpërdrejta, pasi nuk përfshin procese të djegies. Depozitat e karburantit dhe GNL-së do të jenë të mbyllura hermetikisht dhe të pajisura me valvula sigurie që parandalojnë avullimin ose rrjedhjet e gazrave në atmosferë. Gjithashtu, do të shmanget ndezja e motorëve gjatë periudhave të pritjes në pikën e furnizimit, me qëllim reduktimin e ndotjes nga mjetet.

- **Masat për Zhurmat dhe Vibrimet**

Për të minimizuar ndikimet akustike dhe vibrimet, në këtë aktivitet do të përdoren vetëm mjete me tonazh të lehtë dhe pa potencial për gjenerim të lëkundjeve. Zhurmat nga operacionet do të mbahen brenda kufijve të lejuar me ligj, dhe në përputhje me VKM nr. 505/2021 për ndotjen akustike. Pajisjet që përdoren janë të përzgjedhura për efikasitet dhe qetësi gjatë funksionimit.

- **Masat për Ndikimet në Florë dhe Faunë**

Për të ruajtur florën dhe faunën lokale, aktiviteti është projektuar pa ndërhyrje në ekosistemet natyrore dhe pa prekjen e sipërfaqeve me vlerë ekologjike. Gjithashtu, janë ndërmarrë masa për përmirësimin e gjendjes mjedisore përreth përmes mbjelljes së bimeve dekorative në territorin e objektit.

- **Masat për Parandalimin e Zjarrit**

Për menaxhimin dhe parandalimin e zjarrit, pika e furnizimit është pajisur me fikëse zjarri të llojeve të ndryshme (me pudër, CO₂ dhe ujë), në përputhje me kërkesat ligjore për siguri teknike. Objekti është i ndertuar me konstruksione te shkalles se pare te



qendrueshmerise ndaj zjarrit. Ne keto kushte mjedisoret brenda te cileve ushtrohet veprimtaria e depozitimit dhe shitjes se karburanteve eshte brenda normave te mbrojtjes nga zjarri qe do te thote se perputhet me kategorine A, B dhe C te rrezikut te zjarrit qe paraqet veprimtaria qe do te zhvillohet ne objektin ne fjale. Sa i takon instalimeve ekektrike, ndricimi ne pjesen e shitjes se karburantit eshte antideflagrant. Skema e evakuimit eshte e afishuar ne secilin nga mjediset e karburantit dhe i gjithe stafi eshte i njohur me te. Furnizimi me uje i objektit realizohet nepermjet rrjetit public te ujesjellesit si dhe nga depozita qe eshte ndertuar ne mjediset e brendshme te karburantit me kapacitetin 12m³ dhe pompes centrifugale te vendosur per thithjen dhe shtytjen e tij.

Personeli do të trajnohet periodikisht për përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit dhe do të zbatohen kontrole të rregullta mbi instalimet elektrike, valvulat dhe pajisjet për të parandaluar rreziqet e mundshme.

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:

- Largimin e materialeve te ndezshme nga ambientet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
- Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
- Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
- Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces.
- Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuaresive si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidratante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.

➤ **Mbrojtja nga Aksidentet dhe Kushtet në Punë**

Detyrat e subjektit që do të zhvillojë aktivitetin:

- Subjekti do të punësojë punonjës që kanë mbushur moshën përkatëse për punë dhe specialistë të profesioneve që kërkohen, të cilët janë të kualifikuar dhe të trajnuar për të operuar në aktivitete të tilla si furnizimi me karburant dhe GNL.



- Punonjësit do të kenë eksperiencë të gjatë në profesion dhe do të jenë të aftë për të siguruar një mbarëvajtje të sigurt të aktivitetit, duke parandaluar ndonjë incident.
- Para fillimit të punës dhe gjatë zhvillimit të saj, punonjësit do të instruktohen për rreziqet në punë dhe masat për parandalimin e aksidenteve, përfshirë trajnim për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe mjeteve të sigurisë.
- Punonjësit do të pajisen me mjete mbrojtëse dhe uniformat përkatëse për punë, të cilat do të jenë të përshtatshme për veprimtarinë e furnizimit me karburant dhe GNL.
- Instruktimi për përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe rregullat e sigurisë do të bëhet në mënyrë periodike për të siguruar që çdo punonjës është i informuar dhe i gatshëm të përmbushë standardet e sigurisë.

Detyrat e punonjësve:

- Punonjësit janë të ndaluar të përdorin pije alkoolike para fillimit të punës dhe gjatë kohës së punës, për të siguruar koncentrimin dhe kujdesin e duhur në aktivitete që përfshijnë karburante dhe GNL.
- Para fillimit të punës, çdo punonjës do të kontrollojë gjendjen teknike të pajisjeve që përdoren (pompat e karburantit, pajisjet e mbrojtjes, etj.). Nëse mjetet janë në gjendje të rregullt, atëherë punonjësi do të fillojë punën.
- Në rast se punonjësi konstaton ndonjë defekt në pajisjet e përdorura dhe nuk mund ta eliminojë, ai do të ndalojë punën dhe do të njoftojë menjëherë përgjegjësën më të afërt për të marrë masat për riparimin e mundshëm.
- Punonjësit janë të detyruar të përdorin mjetet individuale të mbrojtjes gjatë gjithë kohës së punës për të siguruar mbrojtjen e tyre nga rreziqet e mundshme, përfshirë rrjedhje karburanti, gazra të dëmshëm dhe për të shmangur çdo rrezik tjetër.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

- Zbatohen me rigorozitet të gjitha rregullat e sigurimit teknik në punë për të garantuar kushte optimale të punës për punonjësit, duke minimizuar çdo mundësi aksidenti ose dëmshpërblimi për shkak të gabimeve teknike.
- Mbetjet e lëngshme, përfshirë çdo rrjedhje të mundshme të karburanteve dhe GNL-së, do të shkarkohen në mënyrë të kontrolluar dhe në vendet e caktuara, për të parandaluar ndotjen e mjedisit.
- Depozitat që mbajnë naftë, benzinë dhe GNL janë të pajisura me sisteme flakëpenguese për të parandaluar shpërthimet e mundshme dhe për të siguruar një sistem sigurie të përkryer.
- Subjekti do të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria e personelit të punës, duke i transportuar ato në mënyrë të rregullt në vendgrumbullimet e miratuara nga pushteti vendor për trajtim të mëtejshëm.

**Rekomandime:**

- Kushtet teknike të mjeteve të punës (pompat e karburantit, pajisjet për mbushje GNL, etj.) do të kontrollohen në mënyrë periodike për të parandaluar dhe evituar rrjedhjet e mundshme të lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, si dhe për të shmangur ndotjen nga emetimi i gazeve ose zhurmave të tepërta që mund të shkaktohen nga defekte teknike.
- Shërbimi i automjeteve dhe mbajtja në gjendje të mirë e pajisjeve të punës duhet të realizohet në kushte të tilla që të shmangin ndotjen e mjedisit. Kjo përfshin pastrimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve në zona të dedikuara për shërbim, për të parandaluar lëshimin e karburanteve ose lëndëve të tjera ndotëse.
- Punonjësit do të informohen dhe instruktohen periodikisht mbi kushtet e Lejes Mjedisore dhe për pasojat e moszbatimit të rregullave mjedisore, përfshirë ndotjen që mund të shkaktojë veprimtaritë e tyre.
- Kanalet e drenazhit dhe kullimit të ujërave sipërfaqësore do të pastrohen dhe mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme për të parandaluar bllokimin dhe rrjedhjet e mundshme të ujërave të ndotura nga aktiviteti i furnizimit me karburant dhe GNL.